Disa aspekte të rëndësishme nga trashëgimia jonë letrare në një parafjalë

Assist. Prof. Dr.Teuta Vinca Kafexholli
AAB College
Email: teutavinca@hotmail.com

Abstrakt
Në punimin e zgjeruar përqëndrohemi te fjala e autorit, Mitrush Kuteli (Dhimitër Pasko) titulluar "Parafjalë ose bisedime me katër fëmijët e mi dhe me vetveten rreth këtij libërthi". Qëllimisht përqëndrohemi te kjo parathënie që ka vlerën e një studimi shkencor edhe me përmasa eseistike. Është me rëndësi të veçantë se kjo punë e Kutelit nuk ka qenë e botuar deri tash në asnjë nga veprat e M. Kutelit. Autorja Atalanta Pasko (e bija e autorit) këtë çështje e sqaron në fusnotën përkatëse: "Botohet sipas daktiloshkrimit", për çka flitet në punimin e zgjeruar. Për studiuesit dhe adhudiuesit që janë marrë e mirren me Mitrush Kutelin, ky shkrim mjaft vëllimor, shërben për plotësimin e dijes rreth Mitrush Kutelit. Në punimin tim bëhet fjalë për aspekte të ndryshme, me një theksim të veçantë në atë pedagogjik, eseistik, folklorik, historik etj., ku Kuteli zbërthen të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen duke shpjeguar kohën si në diakroni ashtu edhe në sinkroni. Në këtë parafjalë Kuteli shfaq vlerat, prandaj konsiderohet një traktat i vërtetë studimor për çka flasim në punimin tonë. Përveç vlerave të tjera të theksuara në punim, është edhe përshtatja në gjuhë letrare me sintaksë, leksik, stil që i paraprin gjuhës standarde të vitit 1972, pra Kongresit të Drejtshkrimit. Kështu, letrarishtja e tij është vazhdim i denjë i letrarishtes dhe stilit të F. Konicës, E. Çabejit, F. Nolit etj.

Fjalë kyç: *parathënia, baladat, Tregime të moçme shqiptare, përmasat eseistike, aspekti pedagogjik, aspekti historik, koha në diakroni dhe sinkroni.*

Hyrje

Objekt i punimit tim është vetëm parathënia e Mitrush Kutelit botuar në veprën "Tregime të moçme shqiptare" me nëntitillun "Balada dhe rapsodi popullore" për fëmijët e moshës së mesme dhe të rritur shkollor, të ritreguara nga vet M. Kuteli.Kjo vepër mjaft vëllimore është botuar në Tiranë në Shtëpinë Botuese"M.K." në vitin 2009 me 317 faqe, përgatitur nga dy fëmijët e Mitrush Kutelit: D. Pasko dhe A. Pasko. Në këtë vepër

bëhet fjalë për eposin e kreshnikëve, për baladat dhe rapsoditë shqiptare, në një zhanër që pothuajse është i vetmi në historinë e folkloristikës shqiptare, duke nënkuptuar ndërrim zhanri, që nuk dimë të ketë vepruar ndonjë studiues tjetër si Mitrushi ynë.Pjesë e kësaj vepre është një parafjalë, siç e quan autori, qëpërbëhet nga 35 faqe.

U përcaktova të shkruaj për këtë parathënie që saktësisht është formuluar kështu: "Parafjalë ose bisedime me katër fëmijët e mi dhe vetveten rreth këtij libërthi".

Për ta pasur më të qartë botimin dhe ribotimin e kësaj parathënie, vura kontakt elektronik me studiuesen e Mitrush Kutelit, zonjën Atalanta. I shkrova dhe mora këtë përgjigje: *"Mirmbrëma Teuta, pata fat se m'u hap FB (kisha ca kohë nuk e hapja dot, por siç duket ti je e mbarë), prandaj po të përgjigjem me kënaqësi të dyfishtë. Këtë parathënie nuk ia pranuan Babait nga shtëpia botuese "Naim Frashëri" pasi e quajtën shumë të gjatë dhe të personalizuar. Atëhere ai shkroi një variant tjetër dhe me atë, pas disa shkurtimesh e zgjatimesh, u botua disa herë deri në vitet '90. Ashtu e botuam edhe ne si familje më 1998, ndërsa në botimet e mëpasme vumë "Parafjalë ose bisedime me katër fëmijët e mi dhe vetveten rreth këtij libërthi ". Këtë parathënie e kemi përfshirë edhe te libri "Shënime Letrare", (2007), botuar në 100-vjetorin e lindjes së Kutelit. Përshëndetje dhe mirupafshim".*

Studiuesit e deritashëm të Kutelit këtë parathënie, "Kujtesën" (drejtuar Komitetit të Partisë për leje pune), "Testamenti", "Një fjalë mbi dy shokë dhe mbi veprëzën e tyre", shkruar nga Izedin Jashar Kutrulia e Dr. Pas, i kanë konsideruar si shkrime që shërbejnë për biografinë, autobiografinë e vet shkrimtarit. Kështu kanë thënë A. Plasari, N. Jorgaqi, A. Uçi. M. Kraja, S. Hamiti, S. Bashota etj.Por më e veçanta e kësaj natyre është pikërisht parafjala për të cilën dua tëpërqëndrohem më shumë.

Nuk di ç'të veçoj e ç'të lë nga kjo parafjalë e mrekullueshme e autorit të "Tregimeve të moçme shqipatare": ato që thotë për Mujin e Halilin, për Hysen Kraposhnikun, Behur Kapedanin, Arnaut Osmanin e Hysen Radoicën, për Tanushen, Ajkunën e dhembshur, për Omerin e Ri apo për Zanat e Orët e bardha të "mbështjella me atë napën e poezisë madhore, poezisë së vërtetë " dhe ndalem përsëri te fjalët margaritarë të popullit e të M.Kutelit... Ja se si e jep portretin e Hysen Kraposhnikut "... është fisnik, trim, vëlla shpirtëror i Gjergj Elez Alisë, Ymer Deliu,vëllam i Hysos – është po ashtu i fismë dhe e do me shpirt Hyso Kraposhnikun... Omeri i vogël është trim si i ati... Dhe vini re: Muji nuk e lejon të bëjë gjëmë në shtëpi, që të mos gëzohet armiku, po e porosit të vajtojë në bjeshkë kur të shkojë për dru si gjithë malësoret... dhe Ajkuna është nëna e përvëluar që

vajton djalin e saj të vrarë në luftë dhe sa lirizëm kumbon në fjalët e saj! I lutet të birit të dalë nga varri, t'i hypë gjogut e të shëtisë me gazmend bjeshkëve, të gëzojë jetën, të ritë e tij..." Dhe fjalët e Mujit të vijnë në çdo çast të jetës me etnopsikologjinë shqiptare, ato që thamë më lartë: " S'dua gjëmë në shtëpi, që të mos gëzohet armiku..."[1]

Kështu rresht pas rreshti dëgjojnë lexuesit shqiptarë, dëgjojnë apo lexojnë fjalët modeste të Kutelit: "Doemos duke u kthyer në tregime, pra në prozë, baladat dhe rapsoditë kanë humbur shumë nga bukuria dhe freskia e tyre, nga hovi këngëtar, nga ngjyrat e shumta të poezisë. Shkurt: kanë humbur thelbin e tyre poetik. Aty kanë mbetur vetëm skeleti apo zhvillimi i ngjarjeve, ndërsa është zhdukur tërë ndjeshmëria magjepëse e poezisë. Sepse, të përpiqesh ta kthesh këngën në tregim është pothuaj e njejta gjë sikur të përpiqesh ta futësh qiellin e kaltër në një kuvli të errët apo ta ngjeshësh tërë pranverën brenda në trastë. Prandaj kështilla e parë që u jap lexonjësve, sidomos të rinjve, është që, shpejt a vonë, sapo të kapërcejnë vështirësitë dialektore,të përpiqen që të lexojnë drejtpërsëdrejti baladat dhe rapsoditë tona dhe të mbushin shpirtin me bukuritë e pashembullta të fjalës artistike që ka krijuar populli ynë gjatë shekujve". [2]

Janë hequr edhe 8 rreshta që janë origjinali e që këtu po i rishkruajmë: " Dhe atëherë, kur do të arrijnë të shijojnë drejt nga burimi bukurinë e vërtetë të thesarit tonë, mbase do të thonë ndonjë fjalë të hidhur për shkronjësin e këtyre rreshtave, kthenjësin e këngëve në tregime, se nuk e pat dhënë veçse një shëmbëllesë të zbehtë e pa ngjyra nga baladat e rapsoditë tona të moçme, po unë u jap fjalën se do t'i pres me gaz këto qortime të drejta, vetëm e vetëm të di se munda të nxit të rinjtë tanë që ta shuajnë etjen e njohjes drejtpërdrejt nga burimi i artit tonë popullor" (Vepra 4. f.10,Tr. 1990). Ç'modesti shkrimtari e ç'virtyt shqiptari te Kuteli ynë, përkundër atyre megalomanëve e egocentrikëve që preferojnë prore të

[1] M. Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare,* Kuteli `04, Tiranë, 2009, f.189.

[2]Le të vihet re lokucioni "sa të kapërcejnë vështirësitë dialektore" bashkë me fjalët e fundit të parafjalës ,që flasin se ç'qëndrim ka M.Kuteli ndaj poezisë, këngës dhe ndaj prozës. A ka të drejtë do të pyeste ai që ka bindjen se Kuteli është mbret i prozës tregimtare shqipe. Ai e di se proza jep mundësi të gjera për shumëvlerësinë artistike të personazheve., por nuk bëhet narcisoid të flasë për veten e tij se ai ia ka kaluar autorit të popullit. Dhe të vjen keqqë në botimin e Prishtinës, Rilindja, 1971 ka ndryshime të karakterit cenzurues apo edhe shkurtime. Kështu në f.13, fjalia " t'i pushtonin njerëzit e kralit" është ndryshuar "tëcilat donin t'i pushtonin të tjerët" që në botimin e Prishtinës, Rilindja, 1971 ka ndryshime të karakterit cenzurues apo edhe shkurtime. Kështu në f.13, fjalia " t'i pushtonin njerëzit e kralit" është ndryshuar "tëcilat donin t'i pushtonin të tjerët".

maten me hijen e mëngjezit! Dhe *shohim fytyrat e brezit* të ri që më duket se i fusin në gjak fjalët e Kutelit kur thotë: "*Një popull që nxjerr heronj të tillë dhe që thur këngë kaq të bukura për të lavdëruar heronjtë e tij, mund të mbahet gjithnjë krenar dhe të shikojë plot besim të ardhmen e tij".* Po ne do të shtonim se një popull që ka shkrimtar të kalibrit të Dhimitër Paskos, pra të Kutelit, ndihet dhe do të ndihet krenar.

Për këtë parafjalë do të ndalemi veçanërisht, sepse ka vërtet çështje që për herë të parë bëhen publike, si për kohën ashtu edhe hapësirën konkrete. Për studiuesit kjo parafjalëështë një befasi e këndshme, sepse ai për personazh nuk i merr personat fiktiv, as historik, por drejtpërdrejt bën dialog me fëmijët e tij. Pra më 4 prill të vitit 1964 e paska bërë këtë shkrim me 35 faqe që deri tani nuk është ditur, ose vetëm pjesërisht është lexuar. Është shkrim shumë interesant si për kronotopin, si për stilin, si për narracionin e si për personazhet fëmijë, që në kalim kohe i njeh kultura shqiptare, pra Pandi, Atalanta, Polikseni dhe Doruntina. Ai para tyre flet me masa pedagogjike për shekullin XV (koha e caktuar) dhe me ngjarje të kohës së përherësisë, për heronjtë e kombit si dhe për tradhëtitë e Ballabanit etj. Rrëfimi i Kutelit është një rrëfim i vërtetë, një rrëfim sa historik aq edhe poetik, duke kaluar nga kohët e vështira e në hapësira plot mynxyra.

Le të vihet re si shkruan M. Kuteli për Gjergj Elez Alinë : "Dhe më në fund – oh, sa i dhimbshëm është fundi! – Gjergj Elez Alia kthehet në shtëpi, mbledh shokët, u fal këtyre gjithçka: shtëpinë, mallin, paratë dhe u le amanet të motrën. Më tej vjen vdekja e të dyve – e vëllait dhe e motrës – varri i përbashkët... Ata vdesin të pastër, të papërlyer, si heronj".

Pra, ritheksojmë që këtë trajtë të të shkruarit kurrë s`e kemi pasur në shkrimet e mëparshme tëMitrush Kutelit. Ai ligjëron për baladat tona, marrë nga vreshta e popullit... Pastaj hyn në etimologji dhe sqaron fjalën baloz, nocionin historik Taulant, fjalën mali i Dajtit, që paska kuptimin dallëndyshe, pra mali Dajt na qenka mali i dallëndysheve. Le të vërehet si merr rolin e edukatorit dhe tërhiqet me mjeshtri duke thënë se këto çështje le t`i sqarojnë gjuhtarët e jo ne që "vjelim vreshtin" e folklorit tonë të pasur që na bën të krenohemi. Dhe ja fjalia që ka hy thellë në vetëdijen e rinisë: "Populli që ka aftësinë të këndojë kështu, s`mund të zhduket". Bindemi se është e vërtetë se Kuteli e njeh historinë në gishta. Shifet edhe te kjo parafjalë gjatë dialogut me katër fëmijët e tij për Ilirinë, për brigjet e Vardarit e gjer nëbrigjet e Danubit. Ai bën një dialog me fëmijët e tij që i quan "rebelë" dhe shtron shumë pyetje për t`i nxitur të mendojnë për tema e ideale të larta, dhe kur ata s`janë në gjendje të përgjigjen, ai flet e sqaron vetë.

Në këto faqe që botohen për të parën herë, Kuteli shndërrohet në një ideolog (ideator) duke zbërthyer të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen. Ai bën ligjëratë patriotike e një traktat filozofik mbi luftrat e mbi padrejtësitë nga sunduesit e huaj e nga fqinjët për gllabërimin e Shqipërisë. Tre vjet para vdekjes, apo disa decenie pas burgut, Kuteli bën këtë shkrim që për fat qenka ruajtur. Shpjegon tri kohë, si në diakroni ashtu edhe në sinkroni: koha e Ilirisë, ajo e Skënderbeut dhe ajo e pas vitit 1913, kur duke rrëfyer i ngashëryer, i këputet fjala në gjysëm: "Për ne kënga e Ymer Agës ka edhe një kuptim tjetër: na kujton Ulqinin, atë qytetin e lashtë Ilir dhe më vonë Arbër, një nga stolitë më të bukura të anëdetit shqiptar, të banuar krejt nga shqiptar, dhe që sot, bashkë me Tivarin e shumë qytete të tjerë...". Dhe i prekur, fjala i mbetet përgjysmë. Krejt kjo është një orë historie e nxënës katër "rebelët" e M. Kutelit dhe gjithë vogëlushët shqiptar bashkë me prindërit e tyre.Pra kjo parafjalë do konsideruar si një meditim i vërtetë dhe i thellë i M. Kutelit, duke shprehur para katër "rebelëve" gjithë shqetësimin e tij të madh dhe konceptin se si duhet shkruar thjeshtë për çështje të mëdha jetësore, siç është meditimi për Faustin e Gëtes e ajo për historinë kombëtare dhe rrudhjen e atdheut copë-copë.

Përmendëm më lart se ai shpreh akumulimin e rëndë që ka në shpirt për çështjet kombëtare por edhe për ato jetësore. Nga shumë mendime të tjera po e veçoj këtë: "Unë i dua shumë këto mëngjese të ëmbla paqeje, ku rreth e qark vlon jeta e gëzuar, kur fëmijët lozin, drurët ngarkohen me lule dhe ze fill jeta e re e natyrës. Më vjen t`i them jetës, si ai Fausti plak i gojëdhënës, i etur për gëzime të reja: 'Jetë, në s`mund ta mbash në vënd hapin tënd të rrëmbyeshëm, të paktën ngadalësoje një çikë, që të ndjej thellëe më thellë shijen e ëmbël të së sotmes, këngët dhe britmat e fëmijëve, flladin e pranverës, erën dehëse të unapit e të jargavanit, që do të çelin nesër, bukurinë e qershisë që do të kuqëlojë së shpejti në degë, shijen e kokrrës së rrushit...' Domosdo, jeta ka rrugët dhe ligjet e veta dhe s`ka nge të dëgjojë trurjet e mia, prapseprapëështë mjaft mëshirëtare dhe më lejon, tani në këtë pranverë, të marr frymë lehtë-lehtë, të shikoj midis gjethëzave të brishta qiellin e kaltër pranveror dhe të ëndërroj s`di çfarë gërshetime fjalësh". (Shih parafjalën f. 9.) Pas notës ditirambeske që hasim në përshkrimet aq të qëlluara, aq të bukura, aq filigraniste të parafjalës së cituar me pasazhe të bukura, unë dua të rikujtoj dy poetët e adhuruar të M. Kutelit: N. Frashërin dhe A. Z. Çajupi. I pari me poezinë "Jeta", i dyti me "Kopshti i dashurisë".Po aq sa kënaqen lexuesit me këto poezi, po aq do të kënaqen nëpër shekuj jo vetëm katër "rebelët" e M. Kutelit por gjithë bota shqiptare me gjuhën poetike, me metaforikën e qëlluar të Kutelit tonë jo

vetëm të talentuar por edhe të përkushtuar sot e gjithmonë “sa mali të bëhet hi e hiri mal përsëri”.

Pra pyetjet e katër fëmijëve apo katër “rebelëve” siç thotë Kuteli janë të lloj-llojshme, janë me shumë interes edhe për studimin e letërsisë, edhe të historisë, edhe të psikologjisë, edhe të mitologjisë, pra çështje interdiciplinare apo intertekstuale. Ja disa pyetje:

“Po ç`janë balozët, baba?; Më thoni ç`ka qenë Muji përpara se të bëhej luftëtar?; Ndryshohet gjuha, baba?; Ka edhe luftë të padrejtë, baba?; Dini ndonjë tradhtar tjetër?; I lik ishte Ballabani, baba?; E vranë shqiptarët?; Po Skënderbeu si ish?; Po Omeri i Mujit si ish?; I lik është balozi i detit?; Që ku vjen emri Ulqin, baba?; Pse heshte, baba? Pse rri ashtu i pikëlluar? etj. Të gjitha këtyre pyetjeve Kuteli u përgjigjet mjeshtërisht si prozator e saktësisht si historian dhe si patriot. Pas pyetjessë fundit ai kishte “në mendje dhe në zemër këto gurgullima”, që nuk ua tha fëmijëve, sepse ata ishin të vegjël, dhe shkrimtari ynë kish frikë se nuk i kuptojnë.

Ja një pasazh i shkëputur : “Vërtet rrija i pikëlluar. Kështu më ndodh ngaherë kur kujtoj lashtësitë tona, historinë tonë shumë të hidhur, humbjet e mëdha gjaku dhe trualli. Ja se ç`bluaja në mëndje. Nga të tre fiset dardane të Spartës, të dalluar kaq shumë me burrërinë e tyre në lashtësinë helene, njëri ishte krejt ilir, tjetri ishte i përzjerë dhe në të mbizotëronin ilirët. Aleksandri i madh i Maqedonisë ishte ilir nga e ëma dhe ilirishten e kish të vetën, si gjuhë mëme, aq më fort se ish rritur e burrnuar në Iliri. Edhe i ati, Filipi, e dinte këtë gjuhë sepse maqedonët ishin fis me ilirët. Aleksandri, i biri, pushtoi botën sidomos me luftëtarët e tij ilirë që i zen në gojë edhe historia, dhe ia fali këtë botë kulturës helene. Konstandini i madh, rimëkëmbësi i perandorisë romane dhe themelonjësi i perandorisë bizantine, ish ilir nga Naisus dhe kish krah të djathtë ushtrinë e tij ilire. Po ashtu edhe shumë perandorë të tjerë. Më këtej shqiptarët derdhën gjakun e tyre për Turqinë në qindra e qindra fusha lufte. Në kryengritjen greke të viteve 1821-1829 rolin e parë të luftës, atë të shpatës, e lojtën shqiptarët e Moresë, ata të ishujve, barbaçët e Athinës, suliotët e shumë fise të tjera shqiptare që derdhën gjakun për Greqinë. Miauli, Boçari e sa e sa heronj të tjerë ishin thjesht shqiptarë. Kur u shpall shteti grek i pavarur kish vetëm 800.000 njerëz, nga tëcilët pjesa më e madhe ishin shqiptarë dhe vllehë. Të gjithë këta, siç thotë i ndjeri profesor Nikolla Jorga, i përpiu abetarja greke, kultura greke. Dhe mjerisht, vendi ynë, ky cep i Ilirisë së moçme, për shkak të përçarjeve vazhdoi të mbetet në errësirë, në robëri.

Këto bluaja në mëndje, po s`ua tregova fëmijëve. Ata janë shumë të vegjël dhe druhem se nuk kuptojnë dot këto...”. (Po aty)

Në rreshat e fundit ai prek edhe asimilimin e shqiptarëve të shpërngulur me dhunë në Anadoll, të cilët merrnin me vete rapsoditë e tyre të lashta. Pastaj ai shtron një pyetje trishtuese pikërisht për rapsoditë: "Po ç`rëndësi kanë rapsoditë përpara njeriut që zhduket fizikisht, përpara kombësisë së humbur!"

*

Është me rëndësi të veçantë se kjo punë e Kutelit nuk ka qenë e botuar deri tash në asnjë nga veprat e M. Kutelit. Autorja Atalanta Pasko (e bija e autorit) këtë çështje e sqaron në fusnotën përkatëse: "Botohet sipas daktiloshkrimit", për çka flitet më sipër.

Për studiuesit dhe adhuruesit që janë marrë e mirren me Mitrush Kutelin, ky shkrim mjaft vëllimor, shërben për plotësimin e dijes rreth Kutelit.

Për këtë parafjalë mund të shkruhet edhe më shumë por po ritheksojmë se kjo parathënie ka vlerën e një studimi shkencor me përmasa eseistike, pedagogjike, folklorike, historike etj. Aty Kuteli zbërthen të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen duke shpjeguar kohën si në diakroni ashtu edhe në sinkroni. Në këtë parafjalë Kuteli shfaq vlerat, prandaj konsiderohet një traktat i vërtetë studimor.

Referencat

BULO, Prof.Dr.Jorgo, *Për një tipologji të narracionit në prozën e Mitrush Kutelit*, Studime Filologjike, Tiranë, nr. 1-2,2002.

BASHOTA, Dr. Sali, *Kuteli,prozator,poet,kritik, Rilindja 1999.*

ÇABEJ, Dr.Eqrem, *Për gjenezën e literaturës shqipe*,Rilindja,Prishtinë, 1970.

FETIU, Dr.Sadri, *Balada Popullore Shqiptare- Aspekte krahasimtare, IAP*, Prishtinë, 2000.

FROJD Zigmund, Metapsikologjia, F. Noli, Tiranë, 2005.

GJOKA, Behar,*Teoritika e shpështjellimeve kuteliane verifikuese*, Drita, 8 maj 2005.

HAXHIASANI, Qemal, *Epika legjendare*, vëll.I, IF,Tiranë, 1966.

KADARE,Ismail. *Autobiografia e popujve në vargje*, Onufri,botimi i tretë, Tiranë, 2002.

KUTELI, Mitrush, *Tregime të moçme shqiptare*, Kuteli `04, Tiranë, 2009.

KUTELI, Mitrush, Tregime të moçme shqiptare, Rilindja,Pr.1971.

LAJÇI, Dr.Lulzim, *Skënderbeu në veprën e Kutelit*, Studime historike 1, IAP, Prishtinë, 2006.

MEHMETI, Prof.Dr.Enver, S*yzhetë e përrallave dhe të gojëdhanave në kompozicionet e këngëve legjendare,* GJAP, Folklor dhe etnologji,24-1994, Prishinë, 1995.

PAPLEKA, Ndoc, *Kulte,rite,magji në traditën orale,*Toena,Tr.1999.

PROPP, Vladimir, *Morfologjia e përrallës*, Aleph, Tiranë, 2004.

TODOROV, Cvetan,*Poetika e prozës*, Panteoni- Shtëpia e librit, 2000.

UÇI, Alfred, *Estetika brenda rrëfimit kutelian*, gazeta SHQIP, Tiranë, 25 gusht 2007.

ZHEJI, Gjergj, *Folklor shqiptar*, Tiranë, 1998.